



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Kryesuese e KD-së  
Mr. Ardiana Bunjaku

Nr. Prot.: 5/55  
Datë: 31/12/2018

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", bazuar në nenin 13, paragrafi 1, pika 1.14 dhe nenin 22, paragrafi 1, pika 1.3 të Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur me datë 20.12. 2018, mori:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet në parim themelimi i Qendrës së Shkencës së të Dhënave në kuadër të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".
- II. Funkcionimi i Qendrës së Shkencës së të Dhënave do të bëhet pas miratimit të Rregullores së Qendrës, nga Këshilli Drejtues i Universiteti të Prishtinës.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**A r s y e t i m**

Duke pasur parasysh rëndësinë e Qendrës së Shkencës së të Dhënave, si është qendër ndërdisiplinore, hulumtuese shkencore, që synon të gjenerojë vlera nga njohuritë e nxjerra prej të dhënave, përmes teorive dhe teknikave të analizës së të dhënave, si dhe ofrimin e shërbimeve të të gjitha kapaciteteve që do të jenë në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimin e sistemeve mësimore për grumbullimin dhe ruajtjen e të dhënave, Këshilli Drejtues i UP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi t'iu dorëzohet:**

1. Arkivit të UP-së;
2. Parashtruesit të kërkesës;
3. Prorektorit për kërkime shkencore;
4. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së;
5. Zyrës Ligjore të UP-së;
6. Asistentes së KD-së;
7. Për publikim në ueb-faqe të UP-së.



Këshilli Drejtues i UP-së

Mr. Ardiana Bunjaku - kryesuese